



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Informacion periodik i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mbi çështjet e regjistruara dhe vendimet

Kolegji i Posaçëm i Apelimit vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Deri në datën 31 dhjetor 2025, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka shpallur 393 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit, nga të cilat 12 janë shpallur në vitin 2018, 34 janë shpallur gjatë vitit 2019, 42 gjatë vitit 2020, 38 vendime gjatë vitit 2021, 49 vendime gjatë vitit 2022, 55 janë shpallur gjatë vitit 2023, 66 vendime gjatë vitit 2024 (1 vendim rishikim vendimi i çështjes në themel) dhe 97 vendime gjatë vitit 2025.

Në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar gjithsej 417 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, 40 gjatë vitit 2018, 62 gjatë vitit 2019, 63 çështje gjatë vitit 2020, 86 çështje gjatë vitit 2021, 53 çështje gjatë vitit 2022, 57 çështje gjatë vitit 2023 dhe 56 çështje gjatë vitit 2024 (pas datës 31 dhjetor 2024 nuk priten çështje të tjera për t'u regjistruar në Kolegj).

Sa i përket Juridiksionit Disiplinor, deri më 31 dhjetor 2025, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar 25 çështje të këtij Juridiksioni, nga të cilat 2 në vitin 2018, 1 në vitin 2019, 11 çështje gjatë vitit 2021, 2 çështje gjatë vitit 2022, 4 çështje gjatë vitit 2023, 2 çështje gjatë vitit 2024 dhe 3 çështje gjatë vitit 2025.

Deri më 31 dhjetor 2025, janë marrë gjithsej 21 vendime të Juridiksionit Disiplinor, 9 vendime përfundimtare dhe 12 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare. Gjatë vitit 2018 janë shpallur 2 vendime: 1 vendim përfundimtar dhe 1 për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2020 është shpallur 1 vendim përfundimtar; gjatë vitit 2021 është shpallur 1 vendim përfundimtar dhe 3 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2022 janë marrë 3 vendime përfundimtare dhe 4 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2023 janë marrë 3 vendime përfundimtare dhe 1 vendim për moskalim të çështjes në seancë plenare. Gjatë vitit 2024 nuk është marrë asnjë vendim i Juridiksionit Disiplinor. Gjatë vitit 2025 janë marrë 3 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare.

Deri në 31 dhjetor 2025, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar në total për të dyja juridiksionet 442 çështje, 417 prej të cilave, çështje të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe 25 çështje të Juridiksionit Disiplinor. Deri në 31 dhjetor 2025, në Kolegj janë marrë 414 vendime gjithsej për të dyja juridiksionet, 393 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe 21 vendime të Juridiksionit Disiplinor.

Për informacion më të plotë, [klikoni këtu](#).